



financiare për Bashkinë e Mirditës



Krijimi i vendeve

të punës për rinjtë



2025 PRILL

Mbrojtja në një muaj





UZINA E RUBIKUT, QENDËR E PRODHIMIT TË ARMËVE

Uzina e Rubikut do të kthehet në Qendër të Industrisë Ushtarake. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, së bashku me kryeministrin, Edi Rama dhe ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja, inspektuan mjediset e saj, ku zhvilluan një bisedë edhe me ish-punonjës të uzinës. Kryeministri tha se, duke zhvilluar këtë industri, nuk rriten vetëm kapacitetet tona mbrojtëse, por përmirësohet ndjeshëm edhe ekonomia e kësaj zone dhe kombëtare.

★★★★★

mod.gov.al

MM



RIHAPJA E AKADEMISË SË AVIACIONIT NË VLORË

Shkolla e Aviacionit do të rihapet në Vlorë. Kjo falë bashkëpunimit të kompanisë shtetërore KAYO dhe kompanisë prestigjioze izraelite Elbit Systems Ltd. Memorandumi mes dy kompanive u firmos pikërisht në Vlorë, në prani edhe të kryeministrit Edi Rama, zëvendëskryeministres Belinda Balluku, ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralletenant Arben Kingji.

★★★★★

mod.gov.al

RIJETËZIMI I ISH-UZINËS SË AUTOTRAKTORËVE

Ish-Uzina e Autotraktorëve në Shkozë do të rikthehet si një qendër prodhimi e uniformave ushtarake dhe montimit të mjeteve të blinduara. Të pranishëm në prezantimin e këtij projekti ishin kryeministri, Edi Rama, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe ministri i Brendshëm, Ervin Hoxha. Ministri Vengu tha se ky projekt është pjesë e një zinxhiri kombëtar zhvillimi.

★★★★★

mod.gov.al



A photograph of three men in dark suits standing in front of a large ship under construction. The man on the left is clapping, while the two men on the right are shaking hands and smiling. The background shows the complex steel structure of a ship's hull.

MEMORANDUMI PËR NDËRTIMIN E ANIJEVE

Shqipëria dhe Italia nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi mes KAYO, kompanisë shtetërore shqiptare, dhe Fincantieri, kompanisë lidere në botë në ndërtimin e anijeve. Memorandumi synon zhvillimin e industrisë detare në Shqipëri, duke përfshirë ndërtimin e anijeve luftarake dhe civile, si dhe forcimin e kapaciteteve të prodhimit në bazën detare të Pashalimanit dhe u nënshkrua në prani të Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama.

★★★★★



ANIJA ITALIANE “LIBRA” I KALON FORCËS DETARE

Anija italiane patrulluese “Libra” do t’i kalojë në përdorim Forcës Detare shqiptare. Në Durrës u nënshkrua edhe Letra e Qëllimit, në prani të Kryeministrit z. Edi Rama, Ministrit të Mbrojtjes së Italisë z. Guido Crosetti, Ministrit të Mbrojtjes së Shqipërisë z. Pirro Vengu dhe përfaqësuesve të Forcës Detare dhe Marinës Italiane. Ministri Vengu tha se, dhurimi i anijes “Libra” është simbol i marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Italisë.

★★★★★

mod.gov.al



SHQIPËRIA, 16 VJET NË NATO

Në përvjetorin e 16-të të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Kryeministri Edi Rama evidentoj reformat e ndërmarra për modernizimin dhe forcimin e dinjitetit të Forcave të Armatosura, duke nxjerrë në pah sfidat e kaluara gjatë viteve. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi punën, përpjekjet dhe sakrificat e çdo efektivit të Forcave të Armatosura.

★★★★★

mod.gov.al

MM



MINISTRI VENГУ TAKIM ME KAJA KALLAS

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një takim të veçantë me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, njëherësh Zëvendëspresidente e Komisionit Evropian, znj. Kaja Kallas. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ishte në qendër të bisedës mes Kallas dhe Vengut. Ministri përsëriti qëndrimin e pandryshuar të Shqipërisë për të qëndruar krah partnerëve të saj evropianë në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në kontinentin evropian.

★★★★★



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI VIZITË ZYRTARE NË SHBA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm në Shqipëri, gjenerallejtënant Arben Kingji vizitoi shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare të SHBA, gjeneralin Steve Nordhaus në Washington, DC. Në këtë vizitë u nënvizuan lidhjet 24-vjeçare të bashkëpunimit të sigurisë midis Gardës Kombëtare të Nju-Xhersit dhe Forcave të Armatosura Shqiptare përmes programit të partneritetit të Departamentit të Mbrojtjes.

★★★★★



AFA, MARRËVESHJE ME UNIVERSITETIN E VLORËS

Akademia e Forcave të Armatosura dhe Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” nënshkruan tri marrëveshje bashkëpunimi. Ato parashikojnë hapjen e programeve Master në Inxhinieri Armatimi, me profile në Aviacion dhe Detari, shkëmbimin e stafit akademik dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.

★★★★★

mod.gov.al

MM




BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti në një takim ambasadorin e Brazilit në Shqipëri, Tabajara De Oliveira Júnior. Në qendër të bisedës ishte forcimi i bashkëpunimit mes dy vendeve, me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

★★★★★

mod.gov.al

MM



STËRVITJA “FLOOD NORTH ALBANIA”

Për disa ditë, Shqipëria mikpriti stërvitjen “Flood North Albania”, një ushtrim i përmasave rajonale dhe ndërkombëtare për përballimin e emergjencave civile, ku morën pjesë 13 partnerë nga 8 shtete të Ballkanit dhe më gjerë

★★★★★

mod.gov.al

MM